



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL Durrës
DIVIZIONI LIGJOR DHE ADMINISTRATËS

Nr. _____ Prot.

Durrës, më ____ . ____ . 2026

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT

Data: 07 / 08 / 2026

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) “REXHA-CO” Shpk, me Nipt M02430008M me adresë: Tirane Kashar KASHAR Unaza e Re, Rruga Mikel Maruli, Pallati Pienvis, Shkalla 2, Dyqani Nr.4

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **REF-84434-05-06-2026**
“Blerje Barrierash” - 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 07.05.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike Nr.31 datë 11 Maj 2026

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “PC STORE” Shpk, me Nipt L01606034A me vlerë të ofertës ekonomike 7.417.250,28 (Shtatë milionë e katërqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë presje njëzet e tetë) lekë, pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “REXHA-CO” Shpk, me Nipt M02430008M me vlerë të ofertës ekonomike 9,680,000 (Nëntë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “PC STORE” SHPK**L01606034A***Emri i plotë i shoqërisë**Numri i NIPT-it**arsyet e mëposhtme*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori Ekonomik “PC STORE” SHPK, Duke u bazuar në kriterin 2.3.4 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, i cili përcakton se për materialet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun/et ose skadat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen, komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton se këto specifikime teknike nuk përmbushen:

- Motori

Oferta e operatorit ekonomik nuk përmbush kërkesën e specifikimeve teknike lidhur me tipologjinë e motorit. Specifikimet kërkojnë motor elektrik pa furça (brushless DC), ndërsa pajisja e ofertuar është e pajisur me motor me ingranazhe. Ky përbën një ndryshim teknik, pasi motorët brushless ofrojnë jetëgjatësi më të madhe, efikasitet energjetik më të lartë dhe kërkojnë mirëmbajtje më të ulët krahasuar me motorët ingranazhe. Për këto arsye pajisja e ofertuar nuk përputhet me specifikimin teknik të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

- Sistemi i transmetimit

Pajisja e ofertuar nuk përputhet me kërkesën teknike lidhur me sistemin e transmetimit dytësor. Sipas dokumentacionit teknik, sistemi i përdorur është “compression spring + chain and sprocket” (sustë kompresioni me zinxhir dhe dhëmbëzor), ndërsa specifikimet teknike kërkojnë mekanizëm transmetimi të tipit biel-manivelë. Në dokumentacionin e paraqitur nuk evidentohet përdorimi i mekanizmit biel-manivelë, e cila përbën mospërputhje e specifikimin teknik të kërkuar.

- Indeksi i mbrojtjes (IP)

Specifikimet teknike kërkojnë nivel minimal mbrojtjeje IP55, ndërsa pajisja e ofertuar ofron standardin IP54. Ky nivel mbrojtjeje është më i ulët, pasi IP55 garanton mbrojtje më të lartë ndaj depërtimit të pluhurit dhe rezistencë ndaj ujit nga çdo drejtim, ndërsa IP54 ofron vetëm mbrojtje të kufizuar ndaj pluhurit dhe spërkatjeve të ujit. Duke qenë se pajisja është parashikuar për përdorim në ambiente të jashtme dhe kushte rrugore, ky specifikim konsiderohet me rëndësi dhe kjo pajisje nuk e përmbush këtë specifikim.

- USB-C

Katalogu teknik i paraqitur nuk përmban asnjë referencë për praninë e portës USB-C, e cila kërkohet në specifikimet teknike. Në përshkrimet teknike të pajisjes përmenden ndërfaqe dhe komponentë si Modbus TCP/IP, RS485, SD card dhe RJ45, por në asnjë pjesë të dokumentacionit nuk evidentohet presence e portës USB-C. Për rrjedhojë, specifikimi teknik për këtë funksionalitet nuk konsiderohet i përmbushur.

Kriteri 2.3.4 nuk pranohet, duke sjellë skualifikimin e operatorit ekonomik për mosplotësim të specifikimeve teknike si më lartë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “REXHA-CO” Shpk me adresë: Tirane Kashar KASHAR Unaza e Re, Rruga Mikel Maruli, Pallati Pienvis, Shkalla 2, Dyqani Nr.4, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **9,680,000 (Nëntë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë)** lekë, pa tvsh, është identifikuar si ofertues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Liburn Aliu